



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 4.9.2019

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË KONVENTËN PËR PËRPUNIMIN E FARMAKOPESË
EVROPIANE, STRASBURG 22.VII.1964, TEKST I NDRYSHUAR
NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E PROTOKOLLIT
TË KONVENTËS (EST NR.134)

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 4 shtator 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për përpunimin e Farmakopesë Evropiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e Protokollit të Konventës (EST nr.134)”.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Aurora Mara. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj mundëson aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Evropiane.

Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në këtë konventë do të bëjë të mundur pjesëmarrjen me të drejta të plota dhe vendimmarrje lidhur me çështjet e shëndetit publik dhe praktikat më të mira të prodhimit e të shpërndarjes së barnave.

Aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Evropiane, do të mundësojë:

- promovimin, ndër të tjera, të progresit ekonomik dhe social, me përfundimin e marrëveshjeve dhe me veprime të përbashkëta në fushat ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore si dhe në çështjet administrative;

- promovimin e progresit si në fushën sociale, ashtu edhe në fushën e shëndetit publik, për harmonizimin e ligjeve të tyre kombëtare në zbatim të dispozitave të konventës;

- marrjen e masave nga vendet anëtare në lidhje me prodhimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e ilaçeve në Evropë;

- harmonizimin e specifikimeve për substancat mjekësore, të cilat, në gjendjen e tyre origjinale ose në formën e preparateve farmaceutike janë me interes dhe rëndësi të përgjithshme për popujt e Evropës;

- nevojën për të shpejtuar hartimin e specifikimeve për numrin në rritje të substancave të reja mjekësore që shfaqen në treg;

- promovimin e lëvizjes së lirë të produkteve mjekësore në Evropë edhe më gjerë;

- marrjen e masave nga prodhuesit e barnave dhe të produkteve farmaceutike lidhur me zbatimin e standardeve të cilësisë gjatë gjithë ciklit të prodhimit, qarkullimin dhe shpërndarjes së tyre në tregjet e shteteve anëtare të kësaj konvente.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- **Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Aurora MARA

KRYETARI

Ulsi MANJA